

DEKRET
Nr. 456, datë 5.12.2025

PËR DHËNIE DEKORATE

Në mbështetje të nenit 92, germa “ç”, nenit 93 të Kushtetutës, nenit 6, pika 1, të ligjit nr. 93/2022, “Për dekoratat në Republikën e Shqipërisë”, me propozim të Kryeministrit,

DEKRETOJ:

Neni 1

**Dhënien e dekoratës “Kalorës i Urdhrit të Skënderbeut”
zonjës Adriana Hysenaj**

“Në vlerësim të meritave të dalluara dhe të qëndrueshme në mbarëvajtjen e shërbimit të publikut me energji në territore rurale të largëta, me një angazhim profesional dhe personal mbresëlënës në terren, ku prej më shumë se dy dekadash, elektriciste e vetme grua në zonë, punon, riparon, menaxhon sfida komplekse dhe sjell zgjidhje në përditshmërinë e njerëzve, duke dhënë një shembull frymëzues për të gjithë ata që u kushtohen misionëve të shërbimit publik në vend”.

Neni 2

Ky dekret hyn në fuqi menjëherë.

PRESIDENT I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË
Bajram Begaj